



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË · OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilbëno më Datë: 29-11-2024

Nr. i Organiut Org. Broj	Numeri Broj	Subjektet E Prilbëno	Vlera Vrednost
01-	035/02-		1353



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d, neni 40, paragrafi 40.2, pika e të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), të nenit 14, paragrafi 1 dhe paragrafi 8.1 të Rregullores (QRK) Nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, neni 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 27.11.2024 miraton këtë:

V E N D I M

për miratim të dy anëtarëve të komisionit për vlerësimin dhe përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve për institucionet edukativo arsimore të nivelit parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në Komunën e Vitisë

Neni 1

Me këtë Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për dy anëtarët e propozuar për komisionin për vlerësimin dhe përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve për institucionet edukativo arsimore të nivelit parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në Komunën e Vitisë.

Neni 2

Anëtarët e komisionit të propozuar nga DKA, të miratuar nga kuvendi komunal ka këtë përbërje:

1. Zijadin Ahmeti, kryetar i komisionit, zyrtar i DKA-së
2. Mirlinda Sylejmani-Zuka, drejtoreshë e çerdhës Gëzim Ynë - Viti

Neni 3

Përmes këtij vendim konfirmojmë se, personat (nr. rendor 1 dhe 2) të shënuar më lartë përmbushin kriteret të jenë anëtarë të komisionit, sipas Rregullores 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar.

Neni 4

Periodha kohore e mandatit të anëtarëve të lartëcekur do të jetë njëvjeçare nga momenti i miratimi të këtij vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Arsim e Komunës së Vitisë.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Anëtarëve të komisionit;
2. zyrës së Kryetarit;
3. Drejtoria për Arsim; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI
Bekim Azizi

